



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:119106

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05736216

KPPP.nr. 1563/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Blic Productions” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 811566910 dhe seli në Prishtinë, rr. “Tringë Smajli”, Z4-Z3, kundër debitorit “Radio Televizioni Dukagjini” Sh.P.K, me numër të regjistrimit të biznesit 810420323 dhe seli në Obiliq, rr. “Gjergj Fishta”, Magjistralja Prishtinë – Mitrovicë, km 3, Shkabaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 489/22, i lejuar me datë 18.05.2022, nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 27.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “Radio Televizioni Dukagjini” Sh.P.K, me numër të regjistrimit të biznesit 810420323 dhe seli në Obiliq, dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 489/22, i lejuar me datë 18.05.2022, nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 1,500.00.
- II. REFUZOHET pjesërisht si i pabazuar prapësimi i debitorit “Radio Televizioni Dukagjini” Sh.P.K., e numër të regjistrimit të biznesit 810420323 dhe seli në Obiliq, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 489/22, i lejuar me datë 18.05.2022, nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, për borxhin në lartësi prej 14,250.00 MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme – Faturës nr. 01/2021, e datës 01.07.2021; Faturës nr. 02/2021, e datës 01.07.2021;

Faturës nr. 03/2021, e datës 10.08.2021; Faturës nr. 04/2021, e datës 12.11.2021; Faturës nr. 05/2021, e datës 28.12.2021; Faturës nr. 01/2022, e datës 07.01.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 489/22, të datës 18.05.2022, me të cilin është urdhëruar debitori që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit kreditorit t'ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 15,750.00, me kamatë vonesë prej 8%, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, me arsyetimin se propozimi për përmbarrim nuk i përmban të gjitha elementet e nevojshme për t'u konsideruar i plotë dhe i lejueshëm për ekzekutim. Më tej, ka theksuar se i njëjti është bazuar në disa fatura të cilat nuk janë të nënshkruara nga debitori dhe se nënshkrimi në faturë nuk dihet se i kujt është. Ndërsa ka shtuar se një faturë për tu konsideruar si dokument i besueshëm duhet jetë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga ana e debitorit. Në fund, ka theksuar se shërbimet debitori nuk i ka pranuar dhe nuk ka shfrytëzuar hapësira reklamuese sipas faturës së lëshuar nga kreditorit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarrimor ta anulojë.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbarrimor janë të nënshkruara dhe të konfirmuara nga persona të autorizuar nga debitori, e që vërtetohet edhe përmes deklaratës së konfirmimit të borxhit për auditimin e pasqyrave financiare, e nënshkruar me datë 16.04.2022, me të cilën debitori ka kërkuar konfirmim për borxhin që ka ndaj kreditorit. Ka shtuar se në lidhje me mospërputhjen e shumës së konfirmuar të borxhit në vlerë prej EUR 14,250.00 dhe shumën e kërkuar në propozimin për përmbarrim në vlerë prej EUR 15,750.00, në ndërkohë është lëshuar edhe një faturë nr. 01/2022, e datës 07.01.2022, e cila është përcjellë përmes postës elektronike dhe e cila poashtu nuk është përmbushur nga debitori. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarrimor të vërtetohet

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në mbështetje të dispozitave të cekura si më lartë, gjykata vendosi si në pikën I të këtij Aktvendimi duke anuluar pjesërisht urdhri përmbarimor për borxhin në lartësi prej EUR 1,500.00 sipas Faturës nr. 01/2022, e datës 07.01.2022, ngase kjo faturë nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, ngase kreditori nuk ka dëshmuar se të njëjtën faturës ia ka dorëzuar dhe se debitori të njëjtën e ka pranuar dhe është njoftuar për detyrimin që buron nga kjo faturë. Andaj, fatura si të tilla rezultojnë të jenë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe rrjedhimisht është e përshtatshme për përmbarimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke lënë në fuqi urdhrin përmbarimor për pjesën e detyrimit në lartësi prej EUR 14,250.00, ngase lidhur me këtë pjesë të detyrimit dokumentet e besueshme, përkatësisht Fatura nr. 01/2021, e datës 01.07.2021; Fatura nr. 02/2021, e datës 01.07.2021; Fatura nr. 03/2021, e datës 10.08.2021; Fatura nr. 04/2021, e datës 12.11.2021, si dhe; Fatura nr. 05/2021, e datës 28.12.2021, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, është emërtuar qartë objekti i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Poashtu, gjykata gjen se të njëjtat fatura janë lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori dhe për më tepër, bazuar në deklaratën për konfirmimit të borxhit e vulosur dhe nënshkruar nga debitori, rezultojnë se i njëjti ka qenë i njoftuar me detyrimin që buron nga faturat objekt përmbarimi.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e

përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1563/23, datë 27.05.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.